



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 493 prot.

Tiranë më 25.10.2023

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR**

NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Gjykata Administrative e Apelit shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe atë pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

I. 1 (një) Sekretar Gjyqësor, Kategoria IV - 1

Pozicioni më sipër i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai wshtw i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE

09.11.2023

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

15.11.2023

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionet si më sipër është:

1. Sekretari gjyqësor kryen detyra procedurale në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.
2. Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:

- a) vërteton aktet e gjykatës dhe lëshon vërtetime, apo kopje të njësuara me origjinalin të akteve procedurale gjyqësore. Kur përdoren pajisje regjistrimi, apo pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi, ose riprodhimi, është origjinal dhe i paprekur;
- b) është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur, apo të nxjerrë, nga gjykatat dhe gjyqtarët;
- c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave dhe në regjistrimet në regjistra si dhe në mbajtjen e përdorimit të mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike aty ku këto janë të disponueshme;
- ç) ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;
- d) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;
- dh) ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim, dhe në saktësinë e të dhënave;
- e) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

1. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim të aplikantit;
- b- Fotokopje të njësuara me origjinalin të diplomës (*përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit të përcillet njësimi nga MAS*);
- c- Fotokopje të njësuara me origjinalin të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (*ID*);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- g- Vlerësim të fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrim (*për trajnime dhe kualifikime*).

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë, apo drejtpërdrejt, në Gjykatën Administrative të Apelit, Adresa: Rruga "Ismail Qemali" nr.9, Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë, ose përmes email-it zmp.administrativeapelit@gjykata.gov.al, brenda datës **09.11.2023**.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesa nga kandidati i skualifikuar paraqitet në Gjykatë brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.11.2023** Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit (www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit) si dhe në standat e informimit të publikut të Gjykatës Administrative të Apelit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së email-it, për shkaqet e skualifikimit.

FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Data, ora dhe vendi i zhvillimit të intervistës me gojë do të njoftohen në datën **14.11.2023**.

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë janë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Kodi i Procedurës Civile;
3. Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
4. Ligji nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar;
5. Ligji nr. 98/2016 "*Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;
6. Ligji nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;

7. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

Kandidati do të vlerësohet në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- a. 40 pikë për rezultatet e vlerësimit në punë;
- b. 50 pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përvojës së përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë, ose përvojës profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës;
- c. 10 pikë për trajnime, apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse.

Totali i pikëve të vlerësimit është 100.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ (www.klgj.al) dhe të Gjykatës Administrative të Apelit (www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit).

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Ky informacion mund të aksesohet në faqen zyrtare të KLGJ dhe të Gjykatës Administrative të Apelit duke filluar nga data 15.11.2023.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor që plotësojnë kushtet e përgjithshme, sipas nenit 21 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
- b) Të ketë të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale, ose çdo lloj përvoje tjetër që lidhet me gjykatën.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati që aplikon duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim të aplikantit;
- b- Fotokopje të njwsuar me origjinalin të diplomës (*përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit të përcillet njwsimi nga MAS*);
- c- Fotokopje të njwsuar me origjinalin të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive, apo të tjera, të përmendura në jetëshkrim;
- h- Vërtetim nga gjykata;
- i- Vërtetim nga prokuroria.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë, apo drejtpërdrejt, në Gjykatën Administrative të Apelit, Adresa: Rruga “Ismail Qemali” nr.9, Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë, ose përmes email-it zmp.administrativeapelit@gjykata.gov.al, brenda datës **15.11.2023**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21.11.2023** Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit si dhe në stendat e informimit të publikut të Gjykatës Administrative të Apelit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës individualisht, në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së email-it, për shkaqet e skualifikimit.

Ankesat nga kandidati i skualifikuar paraqitet tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidati do të testohen me shkrim për njohuritë mbi:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Kodi i Procedurës Civile;
3. Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
4. Ligji nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
6. Ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
7. Ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*;

Kandidati gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tij të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tij për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATIT

Kandidati do të vlerësohet në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Vlerësimin nga Këshilli, deri në 40 pikë.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës Administrative të Apelit (www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht, në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së email-it, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës

Administrative të Apelit (www.gjkata.gov.al/gjkata-administrative-e-apelit/gjkata-administrative-e-apelit) për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor (www.klgj.al) dhe të Gjykatës Administrative të Apelit www.gjkata.gov.al/gjkata-administrative-e-apelit/gjkata-administrative-e-apelit duke filluar nga data **21.11.2023**.

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Adresa: Rruga "Ismail Qemali" nr.9, Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë, tel +355 42223588,

www.gjkata.gov.al/gjkata-administrative-e-apelit/gjkata-administrative-e-apelit

web: zmp.administrativeapelit@gjkata.gov.al